



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.77

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.47, datë 11.7.2006	Për lirim dhe emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.....	2219
Dekret nr.4974 datë 12.7.2006	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	2219
Dekret nr.4975 datë 13.7.2006	Për emërim ambasadori.....	2220
Dekret nr.4976 datë 13.7.2006	Për emërim ambasadori.....	2220
Vendim i KM nr.477, datë 12.7.2006	Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës.....	2221
Vendim i KM nr.478, datë 12.7.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”.....	2222
Vendim i KM nr.479, datë 12.7.2006	Për dhënie fondi buxhetor Kryqit të Kuq Shqiptar, për promovimin e dhurimit vullnetar të gjakut.....	2222
	Ndreqje gabimi i vendimit nr.434, datë 28.6.2006.....	2223

VENDIM
Nr.47, datë 11.7.2006

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT
RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 84 dhe 86 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Luan Muço lirohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Zoti Arian Sinoimeri emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.4974, datë 12.7.2006

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|------------------------------------|---|
| 1. Amanda Agron Qelija | 16. Klesa Vildan Vathi |
| 2. Sonila Bardhyl Rehova | 17. Arjana Muhamet Vathi (Shehu) |
| 3. Lulzim Myhedin Urëza | 18. Anita Shyqyri Fejzo (Shehu) |
| 4. Erion Shefqet Berberi | 19. Daniel Xhevahir Fejzo |
| 5. Arjan Abedin Sejko | 20. Arben Xhemal Tresa |
| 6. Thodhoraq Selami Sulollari | 21. Siljan Arben Tresa |
| 7. Elsona Jani Kolezi | 22. Agim Foti Shqau |
| 8. Farbardha Nazmi Mikley (Beqja) | 23. Klara Agim Shqau |
| 9. Roland Halit Mara | 24. Mirela Aleks Shqau (Shimplaku) |
| 10. Muhamet Riza Tirana | 25. Almant Shaqir Xheka |
| 11. Fatmira Emerli Zyberova (Lita) | 26. Entela Kristaq Tufa (Stasa) |
| 12. Arber Satki Zuberov | 27. Tefta Spiro Cipo (Angjele) |
| 13. Ilda Nikollë Gugl (Ndreca) | 28. Mirela Mustafa Baumann (Mustafaraj) |
| 14. Venera Humbert Pali | 29. Toni Sokol Delaj |
| 15. Vildan Hamdi Vathi | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4975, datë 13.7.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Roland Bimo, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Holandës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4976, datë 13.7.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Llesh Kola, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Italisë, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Maltës dhe në Republikën e San Marinos, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.477, datë 12.7.2006

PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE TË

PUNËMARRËSVE DHE TË PUNËDHËNËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 200 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfaqësuesit e organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës të jenë si më poshtë vijon:

- | | |
|---|------------------------|
| A. Organizatat e punëmarrësve me përfaqësues nga: | |
| a) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) | 4 anëtarë 4 kandidatë; |
| b) Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH) | 4 anëtarë 4 kandidatë; |
| c) Unioni i Sindikatave të Punonjësve të Shqipërisë (USPSH) | 1 anëtar 1 kandidat; |
| ç) Federata Sindikale e Pavarur e Tregtisë Private, Bankave dhe Shërbimeve të Shqipërisë (FSTBSH) | 1 anëtar 1 kandidat. |
| B. Organizatat e punëdhënësve me përfaqësues nga: | |
| a) Këshilli i Organizatave të Punëdhënësve të Shqipërisë (KOPSH) | 2 anëtarë 2 kandidatë; |
| b) Bashkimi i Organizatave të Biznesit Shqiptar (BOBSH) | 2 anëtarë 2 kandidatë; |
| c) Konfederata e Këshillave të Organizatave të Punëdhënësve (KOP) | 2 anëtarë 2 kandidatë |
| ç) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH) | 2 anëtarë 2 kandidatë; |
| d) Bashkimi i Industrialistëve dhe Investitorëve të Shqipërisë (BI&ISH) | 1 anëtar 1 kandidat; |
| dh) Konfederata e Industrialistëve të Shqipërisë (Konfindustria) | 1 anëtar 1 kandidat. |

2. Emërimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me propozimin e organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve.

3. Vendimi nr.61, datë 23.1.2003 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.478, datë 12.7.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.787, DATË 14.12.2005 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 10, pika 3 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 20 e vendimit nr.787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“20. Masa e ndihmës ekonomike për prindërit e fëmijëve të lindur si:

- a) trinjakë është 3000 (tre mijë) lekë në muaj, për çdo fëmijë;
- b) katërnjakë është 4000 (katër mijë) lekë në muaj, për çdo fëmijë;
- c) pesënjakë është 5000 (pesë mijë) lekë në muaj, për çdo fëmijë.

Kjo ndihmë ekonomike përfitohet deri në mbarimin e arsimit të detyrueshëm, por jo më shumë se 18 vjeç.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, grupi 25, titulli 064, kap.1, artikulli 606 , “Transferta të familjet dhe individët”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.479, datë 12.7.2006

PËR DHËNIE FONDI BUXHETOR KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR, PËR PROMOVIMIN E DHURIMIT VULLNETAR TË GJAKUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7864, datë 29.9.1994 “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshillit të Ministrave

VENDOSI:

1. Kryqit të Kuq Shqiptar t’i jepet fondi buxhetor prej 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh, për promovimin e dhurimit vullnetar të gjakut.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2006, zëri “Shpenzime për mallra e shërbime”, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Financave dhe presidenti i Kryqit të Kuq Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NDREQJE GABIMI

Në pikën 3 të vendimit nr.434, datë 28.6.2006 “Për fondin e veçantë në Institucionet Buxhetore”, të Këshillit të Ministrave botuar në Fletoren Zyrtare nr.72-2006, faqe 2085, fjalët “....këshillat e rretheve”, të zëvendësohet me fjalët “.....këshillat e qarqeve”.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 18.7.2006
Doli nga shtypi më 20.7.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 50 lekë